



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/B: 1060/26
Datë/Datum: 10.07.2026

PRISHTINË - PRIŠTINA

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSH) Rruga "MIGJENT" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH.nr.2026/0267

Duke u bazuar në nenin 105 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05, L-068, si dhe Ligjin 05/ L-002, si dhe nenin 48 dhe nenin 50 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Ligji nr. 05/L-031, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm (zbatues kryesor) të arkitekturës dhe inxhinierisë për ndërtimin e Stadiumit të ri në Pejë, në përputhje me kategorin III të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukture të stadioneve, të miratuara nga UEFA (Ritenderim i dytë)" me numër të prokurimit: 207-25-10662-5-1-1. iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit më 10/07/2026, mori këtë:më 10.07.2026, mori këtë

KONKLuzion PËR PERMIRESIM TË VENDIMIT

Ndryshohet/përmiresohet fjalia tek paragrafi i fundit i Vendimit me nr. të protokollit 2026/0267, i datës 10.07.2026 që në faqen 28 e këtij vendimi e cila ka mbetur si gabim teknik plotësohet/ ndryshohet sipas përshkrimit cilën do ta pasqyrojmë në këtë konkluzion:

Pjesa:

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik "Pro&Co Group" SH.P.K te aporvohet si e bazuar, rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur që ta vertetoj vendimin e AK Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm (zbatues kryesor) të arkitekturës dhe inxhinierisë për ndërtimin e Stadiumit të ri në Pejë, në përputhje me kategorin III të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukture të stadioneve, të miratuara nga UEFA (Ritenderim i dytë)" me numër të prokurimit: 207-25-10662-5-1-1.

Ndryshohet/plotëzohet

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik "Pro&Co Group" SH.P.K te aporvohet si e pjeserisht e bazuar, rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur që ta anuloj vendimin e AK Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit lidhur me aktivitetin e

prokurimit "Punë ndërtimore për zbatimin e projektit të hollësishëm (zbatues kryesor) të arkitekturës dhe inxhinierisë për ndërtimin e Stadiumit të ri në Pejë, në përputhje me kategorinë III të rregulloreve dhe udhëzimeve teknike për infrastrukture të stadioneve, të miratuara nga UEFA (Ritenderim i dytë)" me numër të prokurimit: 207-25-10662-5-1-1.

ARSYETIM

Në lidhje me përpilimin e Vendimit PSH nr. 2026/0267, datë 10.07.2026, konstatohet se në faqen me nr.28 është paraqitur një gabim teknik.

Ky gabim teknik përmirësohet/ plotësohet me anë të këtij konkluzioni, duke pasur parasysh se Operatorit Ekonomik ankues i është aprovuar pjesërisht ankesa nga ana e Panelit Shqyrtues sipas arsyetimit në vendim, përkatësisht në Vendimin në fjalë janë bërë ndryshimet e nevojshme sipas këtij konkluzioni.

Kryetari i Panelit Shqyrtues, pasi është njoftuar për lëshimet teknike të evidentuara në Vendimin e sipërpërmendur dhe në përputhje me nenin 50 të Ligjit për Procedurë Administrative, Ligji Nr. 05/L-031, me këtë konkluzion kryen korrigjimin e gabimit teknik në pjesën e arsyetimit të vendimit.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 OE ankues

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së

